

2 Koha e punës e shitoreve në fundjavë
Jo rritjes së orarit të punës të dielave!

3 Të sigurohen pensionet për gjeneratat e ardhshme
Jo reformës së AHV/AVS në kurriz të grave!

4 Minatori kandidat i pavarur për parlamentin shqiptar
Elton Debreshi përfaqësues i denjë i të gjithë punëmarrësve

Nr. 2 | mars 2021 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Pandemia e koronës në kontekstin e migracionit

Pandemia rrit pabarazinë



Kriza e koronës ka prekur të gjithë popullatën, por në mënyrë të veçantë dhe rëndë punëmarrëset migrant* e

Pandemie prek fort mbi mesataren njerëzit me paga të ulëta, në marrëdhënie të këqija pune dhe me status të parregulluar apo të munguar të qëndrimit. Me mijëra thirrje dhe kërkesa për mbështetje të anëtarëve në situatë emergjente që një vit janë një dehi e qartë për ketë.

Hilmi Gashi

Para koronavirusit nuk janë të gjithë të njëjtë. Shumë studime tanimë vërtetojnë: Situata juridike dhe sociale e njerëzve luan një rol të rëndësishëm. Pandemia godet më rëndë ata që fitojnë më pak se sa ata me mirëqenie – sikur në rrafshin shëndetësor ashtu edhe në atë ekonomik.

Studimet socio-shëndetësore të spitaleve universitare të Bazelit dhe Gjenevës në bashkëpunim edhe të Uni Gjenevës dhe të ETH Lozanës – tanimë ofrojnë edhe të dhëna shkencore.

Kushtet e ngushta banesore dhe situata e punës rrisin rrezikun e infektimit

Sikur në Gjenevë ashtu edhe në Bazel kuota e infektiveve në lagjet me të ardhura të ulëta dhe në kushte të ngushta banimi është më e lartë se në zonat e banuara me gjendje më të mirë.

Njerëzit me të ardhura të ulëta shpesh punojnë në sektorët themelorë si shitja, përkujdesja, pastrimi, transporti ose logjistika dhe jo që mund të kryejnë punë në shtëpi (Homeoffice). Përmes kësaj krahas rritjes së rrezikut të infektimit rriten edhe ngarkesat psikike. Që nga shpërthimi i pandemisë Unia kërkon zbatim të përpiktë të kontrolleve bazuar në konceptet mbrojtëse në vendin e punës. Autoritetet duhet që më në fund të rrisin resurset

dhe të përfshijnë organet kontrolluese të partnerëve social.

Për Unia është e qartë, që personat në izolim apo karantinë duhet të posedojnë një dhomë të tyre personale. Nëse është e nevojshme kjo dhomë duhet të ofrohet nga autoritetet. Përpos kësaj strategjia e vaksinimit duhet të merre parasysh faktorët socio-ekonomik. Gjegjësisht: për popullatën në gjendje të eksponuar banimi dhe profesioni nevojiten oferta të shpejta vaksinimi.

Të dobët social gjenden në prag të humnerës

Pavarësisht nga rreziku i infektimit aq më shumë goditen njerëzit që fitojnë pak. Një hulumtim i qendrës për hulumtime ekonomike të ETH Zyrih ka treguar, që situata e personave nga amvisnit me të ardhura nën 4000 franga është tejet e vështirë: Mesatarisht ata kanë humbur rreth 20% të të ardhurave të tyre të mëparshme. Gati çdo i treti ishte i detyruar të merrte kompensim për punë me kohë të shkurtuar; 8% kanë humbur edhe vendin e punës, gjë që ka qar në përgjysmimin e të ardhurave të tyre. Edhe kursimet e tyre kanë ra dukshëm dhe çdo i 9'ti ka hyrë borxh, për të mbijetuar. Amvisnit me të ardhura të larta, në të kundërtën kanë mundur të kursejnë më shumë para. Sësh

për tu befasuar që edhe ngarkesat psikike janë të ndara në mënyrë të pabarabartë: sa më i varfët, aq më e keqe gjendja subjektive shpirtërore që nga shpërthimi i pandemisë.

Zgjidhje kolektive në vend të mikro-menaxhimit

Vetëm një strategji e solidaritetit mund të parandalojë që kriza shëndetësore të shndërrohet në një krizë të theksuar sociale. Vendimet politike duhet të mbështeten më shumë në ekspertizat socio-ekonomike dhe që eliminojnë faktorët strukturor, të cilët forcojnë pabarazinë. Shembulli i Ligjit për të huajt. Shumë të prekur do të mund të kërkonin mbështetje nga asistencat sociale, për të mbyllur vrimat buxhetore. Të huajt heqin dorë nga kjo, pasi kanë frikë se do të rrezikojnë qëndrimin e tyre në Zvicër.

Për të mënjeluar pabarazinë, nevojiten zgjidhje kolektive. Andaj Unia kërkon 100% zëvendësimin të pagës në rast të punës me kohë të shkurtuar tek pagat neto deri në 5000 franga. Asistencat sociale. Pavarësisht nga statusi i qëndrimit, në asnjë rast nuk do të duhej të qonte në pasojë. Pabarazia sociale në rritje duhet të baraspeshohet, p.sh. me një taksë solidariteti për fitimet kapitale p.sh. dividendët.

Editorial



Më 7 shkurt të këtij viti ne revokuem 50 vjetorin e arritjes së të drejtës së grave në Zvicër për të votuar. Më në fund gratë mund të zgjedhin dhe të zgjidhen. Tek kjo luftë sindikatat bartën rolin kryesor: Ato i dhanë grave qysh para vitit 1971 një zë. Gjatë jubileut u mundësua balancimi i përparimeve nga fusha e barazisë. Nëse gjendja sa i përket barazisë është e pakënaqshme, atëherë kjo ka të bëjë me të drejtat e të huajve në Zvicër. Pa të drejtë vote e zgjidhjeje, pa të drejtë zgjedhjeje pasive: Kjo situatë e papranueshme prek një të katërtën e popullsisë zvicerane. Pra, një të katërtën e popullatës, e cila edhe ashtu merre pjesë në jetën ekonomike të vendit. Një e katërta e përbërë nga punëmarrës që vuajnë nga kriza shëndetësore në Zvicër: Hulumtimet aktuale socio-mjekësore janë plotësisht të qarta – pandemia gotët mbi proporcionalisht njerëzit me të ardhura të ulëta. Kjo është një situatë shqetësuese, e cila mund të qojë në një krizë sociale në formë të humbjes së të ardhurave, zvogëlimin e kursimeve e deri edhe tek hyrja në borxhe. Këto parregullsi mund të mënjanohen vetëm përmes një strategjie solidare. Andaj Unia kërkon: 100% zëvendësimin page për të gjitha pagat neto deri në 5000 franga; asnjë pasojë për shkak të marrjes së ndihmës sociale, pavarësisht nga statusi i qëndrimit; një rishpërndarje përballë pabarazive sociale në rritje, për shembull në formë të një takse solidare mbi të ardhurat nga kapitali. Për rrugën solidare të daljes nga kriza.

Martine Docourt,
drejtuese e sektorit politik

News

Zvicra ka deficite demokratike

Zvicra me 7 shkurt festoi 50 vjetorin e ekzistimit të së drejtës për votim dhe zgjedhje për gratë. Por, nga këndvështrimi i Partisë Socialdemokrate (PS) dhe të Gjelbërve shumë njerëz që jetojnë në Zvicër – ¼ e popullsisë pjesëmarrëse në jetën ekonomike – ende nuk mund të marr pjesë në jetën politike. Andaj ata kërkojnë tani të drejtën e votës për migrant*et. «Zvicra e shekullit 21 është e shumëllojshme. Nuk është me tej në përputhje me kohën, një grup i tërë i shoqërisë të përjashtohet nga instrumentet demokratike vendimmarrëse», thotë kryetari i migrant*eve të PS dhe përmes një nisme parlamentare donë të arrijë për ta të drejtën e votës në nivel komunal. Të Gjelbri në të kundërtën duan të drejtën e votës në nivel federal. Kryetari i partisë Balthasar Glätti mbi këtë çështje thotë: «Njerëzit që jetojnë këtu në Zvicër, punojnë, duhet të paguajnë taksat, do të duhej edhe të bashkë vendosin.»

Zvicrës i duhet një «ius soli»

Senatorja Lisa Mazzone (të Gjelbrit/Gjenevë) dhe senatori Paul Rechsteiner (PS/St. Gallen) në mbështetje të ndërsjellët kanë dorëzuar dy parashtrës mbi natyralizimin e gjeneratës së dytë. Lisa Mazzone për natyralizimin e lehtësuar dhe Paul Rechsteiner për «ius spoli» (fitimi i shtetësisë me vendin e lindjes). «Kush ka lindur këtu, duhet edhe të ketë të drejtën e shtetësisë së Zvicrës. Më shumë se një çerek e popullatës zvicerane nuk posedon pasaportën zvicerane. Shumë nga ta kanë lindur në Zvicër dhe janë rritur këtu. Zvicra është vendi në të cilin jetojnë dhe me të cilin janë të lidhur. Zvicra është atdheu i tyre», shkruan Paul Rechsteiner në ueb faqen e tij, dhe shton më tej: «Hapja karshi të drejtës tej restriktive për shtetësi është edhe me urgjente, marrë parasysh uljen e numrit të natyralizimeve që nga revidimi i ligjit për të drejtën e shtetësisë dhe masat e ashpërsimit të tepruar i viteve të fundit mbi heqjen e të drejtës së leje-qëndrimit edhe në rastet e qëndrimit shumëvjeçar apo edhe gjatë gjithë jetës.»



Jo gjeneratë të humbur Covid-19!

Zhvillimet përkitazi me rrethanat jetësore dhe realitetin punues e rinisë dhe të rinjvë të rritur në Zvicër janë shqetësuese. Perspektivat për të ardhmen e të rinjve që janë shëgert apo punëmarrës si dhe atyre që studiojnë janë të pasigurta në krizën e koronës. Shumë nga ta shkaku i mungesës së masave të sigurisë në shkollat profesionale, hendeqeve arsimore dhe vetmisë gjatë punës apo mësimi në shtëpi (Homeoffice/Homeschooling), ndihen të lënë vet. Komisioni i rinisë të Unia kërkon masa shtesë për mbrojtjen e rinisë dhe të rinjve të rritur. Papunësia tek të rinte duhet të zvogëlohet dhe ardhmëria e shëgertëve, studentëve dhe punëmarrësve duhet të jetë e siguruar. Nuk duhet lejuar gjeneratë të humbur Covid-19!

Kushte të mjerueshme të punës tek dorëzuesin e paketave DPD «E pabesueshme se në Zvicër ekziston një shfrytëzim i tillë»

Kohë e stërzgatur e punës, orë të papaguara pune, zbritje nga paga dhe stres i madh. Fajtor për këtë është «Sistemi DPD». Tani punonjësit po angazhohen për tu mbrojtur dhe po kërkojnë respekt.

Hilmi Gashi

Herët në mëngjes në ora 5:30 ngarkojnë paketat. Pastaj nisen për në rrugë. Të dorëzojnë myshterinjve paketat. Pjesërisht shumë të rënda – deri në 50 kg. Ndalim, shkarkim dhe vozitje e mëtejme. S'ka kohë për pauzë. Shpesh rruga e punës është e gjatë. Paguhet vetëm për 8.5 orë. Pjesa tjetër është punë falas. Skaneri i DPD përfshinë gjithçka, vetëm kohën e punës jo.

«DPD përmes një skaneri përcakton jetën time, është një nxitim, që më ndjek edhe natën në ëndrra. Askush nuk mundet gjatë ta përballojë këtë. Gjendja është e keqe. Nëse sindikata donë të na informojë, na bëhet me dije se ne nuk guxojmë të bisedojmë me Unia. Ne të gjithë jemi migrant*e. Ne kurrë nuk dot në besonim se në Zvicër ekziston një shfrytëzim i tillë.», thotë një i prekur.

Shofer*et dhe punonjësit e depove janë organizuar tek Unia dhe nga DPD kërkojnë bisedime. Lista e parregullsisë është e gjatë: vjedhje pagash, zbritje keqpërdoruese nga pagat, orar i stërzgatur pune, pa shtesë për shujta, shkelje të ligjeve mbi punën natën, kontrolle të palejuara të kohës së vërtetë, makina në gjendje të parregullt, shkelje të të drejtave sindikaliste. DPD duhet që të korrigojë këto menjëherë dhe të ulet për bisedime, për të mënjeluar parregullsitë dhe për të korrigjuar e kompensuar vjedhjen e pagave të viteve të fundit.

Shofer*et durojnë mashtrim të mëtejme të kohës së punës

DPD pretendon se të dhënat e dorëzimit nga skaneri nuk u caktohen individualisht shoferëve, kështu që nuk mund të përcaktohet koha e punës. Kjo është gabim që mund të dëshmohet.



Pamje nga aksioni protestues i shofer*eve të DPD të mbështetur nga Unia

Shumë anëtarë të Unia raportojnë, se kanë nënshkruar dokumente nën presion, e të cilat dëshmojnë që në të kaluarën nuk janë bërë orë shtesë. Në vend se të kërkohet dialogu dhe të synohet rrugë për korrigjim e kompensim të punës falas, DPD mbyll sytë për t'iu shmangur përgjegjësisë dhe detyrimeve.

Mbështetja nga sindikatat franceze

DPD i takon postës franceze dhe kështu edhe shtetit të Francës. Unia në fillim të marsit bashkë me sindikatën franceze CGT dhe SUD kanë protestuar para selisë kryesore të DPD të Evropës dhe kompanisë mëmë GeoPost. Pos tjerash kanë kërkuar nga pronarët francez të DPD (Zvicër) A, që të ndikojnë për ti dhënë fund kundërshtimit të papërgjegjshëm të menaxherëve lokal.

Shteti është gjithashtu i sfiduar Inspektorët kantonal -, para syve të së cilëve është ngritur ky sistem, duhet të kontribuojnë që të respektohen përsëri ligjet ter DPD dhe të zbatohet mbrojtja ligjore e punëmarrësve.

Koha e punës e shitoreve Jo rritjes së punës të dielave

Sikur senati ashtu edhe parlamenti federal kanë refuzuar rritjen e të dielave punuese në 12 ditë blerëse. Mbetet edhe me tej në fuqi që kantonet të mund të zbatojnë më së shumti 4 të diela shitëse në vit. Vendimi në parlamentin federal ishte me dallim të vogël: 96 me 93 dhe 4 abstenime.

Ideja e rritjes së trefishtë është kontrabanduar në propozim-ligjin e Covid-it. Kjo duket mjaft cinike, që personeli shitës, i cili gjatë pandemisë është përballur me sprova të vështira, të gjobitet për kontributet e tija.

Prisca Birrer-Heimo nga PS gjatë debatit u shpreh: «Është një abuzim i legjislacionit Covid nëse dikush dëshiron të çmon-

tojë mbrojtjen e punonjësve dhe punën të dielave përmes këtij neni, dhe kjo pa u konsultuar me partnerët socialë dhe grupeve tjera.»

Angazhimi i Unia u shpërblye

Në ditën e votimit në senat Unia bashkë me shitës*et para parlamentit ka kërkuar: «Stop edhe më shumë të dielave pune për shitës*et!» Angazhimi ia ka vlejtur.

Kjo është mënyra e vetme për të ndaluar stresin, presionin dhe fleksibilizimin e njëanshëm të kohës së punës!

Berna deh Zug-u qartazi kundër

Qysh në fundjavën votuese janë refuzuar qartazi parashtrës për zgjatjen e orarit të punës së shitoreve apo rritjen e të dielave blerëse.



Pamje nga aksioni solidarizues me shitës*et e kundër rritjes së punës të dielave

Të sigurohen pensionet për gjeneratat e ardhshme Jo reformës së AHV në kurriz të grave

Parlamenti aktualisht është duke trajtuar reformën e pensioneve AHV21. Është paraparë rritja e moshës së pensioneve për gratë. Në rast të aprovimit të reformës, grave u duhet të punojnë më gjatë dhe pensionet edhe ashtu të pamjaftueshme do të vijonin të uleshin.

Darinka Filipovic

Nuk vjen në shprehje që të rritet mosha e pensionimit për gratë dhe që pensionet të përkeqësohen. Andaj, Unia mbështet apelin e Bashkimit të Sindikatave të Zvicrës «Duart larg nga pensionet e grave»

Nënshkruaje apelin!

Ne nuk duam reformë në kurriz të grave. Në përputhje me kërkesat e grevës së grave, Unia kundërshton vendosmërisht çdo rritje të moshës së pensionit të grave dhe kërkon në

vend të kësaj një rritje pensionesh. Ne kërkojmë:

- Rritje të pensioneve të grave, për tu garantuar siguria në kohën e pensionimit.
- Jo rritjes së moshës së pensionit tek gratë.

Mbi situatën aktuale

Gratë mesatarisht marrën rreth 1/3 më pak pension e sa burrat, këtë, pasi që shumicën e punës e kryejnë pa pagesë.

pagat janë veçanërisht të ulëta. Kjo ka ndikim në pensionet e pleqërisë. Kjo është e turpshme!

Megjithatë komisioni i senatit paraqet një propozim reduktimi të pensioneve të AHV në kurriz të grave. Kjo është e papranueshme.

Shkresa për senatin

Ne duam përfundimisht një siguri pensionimi më të mirë në pleqëri dhe pensione më të larta për gratë. Qysh tani minimumi i garantuar jetik nuk është i siguruar. Është e nevojshme që pensionet e grave të rriten. Gati dy vite pas grevës së grave pason pikërisht e kundërta! Një flakaresh. Kjo duhet të mënjanohet: Ne do t'is shkruajmë një letër të hapur zotërinjve të senatit. Mbështeteni apelin urgjent! Nevojitet një reagim i shpejtë dhe shenjë e qarte për senatin: Kështu nuk bënë!

Përtej kësaj gratë janë viktima të diskriminimit dhe pabarazisë në paga, ato punojnë kryesisht në profesione tipike «të grave», ku



Duart larg nga pensionet e grave!

Të hënën, me 15 mars 2021, parlamenti debatoi draftin e reformës «AHV 21», i cili parashihet rritje të moshës së daljes në pension për gratë dhe një ulje të pensioneve të AHV.

Sindikatat shumë qartë i thonë jo kësaj reforme!

Mbi 314 000 njerëz tashmë kanë nënshkruar me sukses apelin e Bashkimit të Sindikatave të Zvicrës (SGB/USS) dhe Unia kundër rritjes së moshës së pensionit për gratë. Parlamenti duhet ta marrë seriozisht këtë shenjë me peshë. Reforma e AHV në kurriz të grave nuk do të ketë asnjë shans.



Sindikatat zvicerane dorëzojnë shkresën me 314 000 nënshkrime

Greva e grave 2021

Drejtësi sociale domethënë, të luftohet çdo lloj diskriminimi

Përkundër luftës me dekada barazia mes burrave dhe grave në Zvicër deri në ditën e sotme nuk është arritur. Greva e grave e vitit 2019 ka treguar se në vitet e fundit është formuar një lëvizje e fuqishme për barazinë dhe preokupimet e grave. Është e qartë se sindikatat dhe lëvizja e grave shkojnë krah për krah njëra tjetrës.

Marie Saulnier Bloch und Julius Kopp

Lëvizja punëtoresh me kalimin e kohës ka mësuar shumë. Në shekullin e 19 ishte ende një çështje burrash. Gratë duhet të tregoheshin të kënaqura me këtë dhe të qëndronin në rreshtin e dytë. Shumë nga to i kthyen shpinën sindikatave të mëdha dhe krijuan sindikatat e tyre. Më 1885 në Zvicër u krijuan shoqatat e para për gratë. Ishte shoqata çati e këtyre shoqatave, që me 1991 për të parën herë ftoi për të dalë në rrugë me 8 mars me rastin e ditës ndërkombëtare të gruas.

Gratë kështu përmes luftës i siguruan vetes vendin në lëvizjen punëtoresh dhe edhe drejtuesit e sindikatave filluan që të marrin seriozisht preokupimet dhe shqetësimet e grave. Në grevën kombëtare të vitit 1918, në të cilën u kërkuar edhe e drejta e votës dhe zgjedhjes edhe për gratë, gratë luajtën një rol qendror. Që nga kjo kohë sindikatat paraqesin gjithnjë e më shumë shërbenin si një platformë për lëvizjen e grave.



Këtë qershor greva e grave shkon në raundin tjetër. Shumëçka është përmirësuar

që nga greva e parë e vitit 1991. Atëkohë ishin orëndreqëset nga kantoni Jura, të cilat edhe shkaku u pagave të ulëta kanë shkaktuar grevën. Mirëpo, shumë nga kërkesat e atëhershme nuk janë përmbushur deri në ditët e sotme, veçanërisht ato nga bota e punës: edhe më tej gratë fitojnë më pak se burrat, edhe më tej gratë marrin përsipër shumicën e punëve pa pagesë, edhe më tej gratë si në vendin e punës ashtu edhe në hapësirën private e publike përjetojnë ngacmime.

Le të kini kujdes nga ata që thonë se çdo gjë ishte më e mirë në të kaluarën!

Duhet të jemi të vëmendshëm ndaj tendencave reaksionare. Jo, asgjë nuk ka qenë «më herët më mirë». Për asnjë grua. Dhe ndër gratë nuk guxojmë ti harrojmë migrantet apo viktimat e racizmit, të cilat jetojnë në kushtet më të këqija dhe janë më të diskriminuara. Pasi ato kanë një ngjyrë tjetër lëkure, një sfond tjetër, një gjuhë tjetër amtare, një besim tjetër, një status tjetër qëndrimi se sa shumica. Ne, sindkalistet e sindkalistët, migrantet e migrantët, jemi trashëgimtar të historive tona. Ne luftojmë krah për krahë me lëvizjen feministë.

Ajo që në bashkërisht duam, është drejtësia sociale. Dhe drejtësia sociale domethënë të luftojmë kundër çdo lloj diskriminimi. Ky qëllim deri më sot nuk është arritur. Ne para nesh kemi ende një rrugë të gjatë për të bërë. Mirëpo nëse ne mbesim të mobilizuar, ne do të shënojmë rezultate. Kjo është ajo që nënkupton «bashkë jemi më të fortë».

Për informacione më të detajuara drejtohuni tek sekretariati i Unia në afërsinë Tuaj.

Intervista



Lufta e gjatë për barazi në paga

Ajo punon në një institucion social. Kolegu i saj mas-hkull për punën e njëjtë fiton më shumë se sa ajo. Elif M* bënë llogarinë: Për 7 vite ka marrë 80 000 franga më pak se sa kolegu i saj. Ajo ka filluar të luftoj për barazi pagash.

nga Emine Sariaslan

Çfarë padrejtësie ke përjetuar ti në vendin e punës ?

Kolegu im dhe unë bëjmë po të njëjtën punë. Në 7 vite unë kam fituar 80 000 franga më pak se ai. Kjo është diskriminuese. Që kolegu im fiton më shumë ka përpjekje për të arsyetuar këtë, se gjoja ai ka më shumë përvojë pune se sa unë, është më i moshuar dhe se i asiston shefit tonë. Dallimi në moshë do të mund të legjitimonte një dallim të vogël në pagë. Mirëpo përvoja e punës deh situata e punës nuk janë arsye të mjaftueshme për një dallim kaq të madh në paga. Diploma ime universitare dhe përvoja e ime e punës me këtë rast nuk janë marrë fare parasysh.

Si i ke vërejtur ti këtë pabarazi?

Në vitin 2016 kisha një përqindje punësimi më të lartë dhe me shumë përgjegjësi. Aty kam filluar të mendoj mbi pagën time dhe kam filluar të bisedoi edhe me eprorin tim. Eprori im i deriatëhershëm e ka vërejtur se kolegu im fiton shumë më shumë se sa unë, por nuk e ka ditur arsyen, mirëpo ka bërë vërejtjen se në përgjithësi ka parregullsi sa i përket strukturës së pagave. Kërkesën time për pagë ai ia ka përcjellë më tej zyrës së personelit. Mirëpo paga ime është rritur vetëm për një shkallë të ulët. Kjo më ka penguar. Eprori im më ka propozuar që këtë çështje ta adresojë përsëri vitin e ardhshëm dhe ta bisedoi me shefin e ri. Këtë edhe e kam bërë.

Cilat hapa ke ndërmarrë kundër kësaj pabarazie?

Fillimisht kam shtruar një kërkesë me shkrim. Pastaj kam kërkuar dialogun dhe i jam drejtuar edhe autoritetit të arbitrazhit. Punëdhënësi nuk ka mundur të paraqesë argumente konkrete për dallimin në pagë. Unë iu drejtova autoriteteve kantonale. Ato morën parasysh argumentet e punëdhënësit, andaj nuk kishte ndonjë marrëveshje. Pas kësaj pasoi ankesa në gjyqin kantonale. Kjo pa shqyrtuar fare dokumentacionin, mori një vendim arbitrar, i cili bazohej në deklaratat e punëdhënësit. Unë nuk isha i kënaqur me këtë gjykim dhe shkova në gjykatën federale. Ajo, duke iu referuar gjykimin të dhënë në nivelin kantonale, refuzoi kërkesën time. Ajo që vihej re gjatë gjithë këtij procesi ishte se dokumentet e rëndësishme nuk u morën parasysh ose u lanë plotësisht jashtë shqyrtimit.

E rëndësishme: Megjithëse një zyrë e njohur zyrtarisht për ligjin e barazisë përmes një raporti u pajtua me mua dhe e përshkroi vendimin e gjykatës kantonale si arbitrar, ky raport megjithatë nuk u mor parasysh nga gjykata federale.

Tani po e çoj çështjen time tek autoritet ndërkombëtare dhe shpresoj që shqetësimi im të merret seriozisht dhe e gjithë çështja do të shqyrtohet e ndriçohet ligjërisht.

Çfarë mesazhi dëshiron të jepesh mbi luftën për barazi??

Të drejtat e grave dhe të drejtat e njeriut janë arritur tek pas përpjekjeve të mëdha. Këto përpjekje vazhdojnë edhe më tej. Ne të gjithë duhet të ndërmarrim iniciativën dhe të organizohemi. Është me rëndësi të kemi një vizion. Ne duhet të bisedojmë me njerëzit. Ne mund të arrijmë diç vetëm nëse angazhohemi besueshëm dhe vendosmërisht. Unë kam marrë mbështetje të madhe nga familja, miqtë, Unia, shoqëria nga politika, avokat*et. Këtë rrugëtim jemi duke e bërë bashkërisht. Nuk është më vetëm procesi im, ai është bërë proces për të gjitha të drejtat e njeriut dhe të grave. Dhe gjithashtu në një pjesë të lëvizjes për të drejtat e grave në Zvicër.

Besoj se disa gjëra në shoqëri shkojnë ngadalë. Unë dhe të gjithë rreth meje jemi duke kontribuar për këtë ndryshim. Shpresojmë që diçka të ndryshojë për të gjitha gratë. Gjëja më e rëndësishme është të bësh diçka për rezistencën. Ne duhet t'i dimë të drejtat tona në mënyrë që të jemi në gjendje të mbrojmë veten si individë dhe si shoqëri. Dëshiroj të përfitoj nga ky rast dhe të falënderoj sindikatën Unia për mbështetjen që më kanë dhënë në luftën për barazi.

*Emri është i njohur për autoren

Ju pyesni, Unia përgjigjet

Unë nuk guxoi të largohem nga shtëpia e mallrave gjatë pauzës 15 minutash. A duhet firma të paguajë këtë kohë?

Unë punoi si shitës në një shtëpi mallrash. Kontrata e punës parasheh pauzë 15 minutash pa pagesë para dhe pasdite. Largimi nga ndërtesa gjatë pauzës nuk lejohet. Punonjësit kanë në dispozicion restoranti i personelit dhe një dhomë e madhe shtesë për pauza. Sipas pikëpamjeve të mija firma duhet të kompensojë këto pauza, derisa nuk lejohet largimi nga objekti i punës. A kam unë të drejtë në këtë mendim?

David Aebly: Jo, mjerisht jo. Sipas ligjit të punës, pauzat vejnë si kohë e paguar pune vetëm atëherë kur punëmarrësit nuk guxojnë të lënë vendin e punës. Si vend pune vlenë çdo vend në ndërmarrje apo jashtë ndërmarrjes, në të cilin punëmarrësi duhet të qëndrojë për të kryer punën që i është ngarkuar. Si vend pune, pra vlen vendi konkret, në të cilin punoni. Nëse pauza bëhet në një vend të veçantë të paraparë për pauza, kështu sipas vendimit të marrë nga gjyqi federal, vlen si largim nga vendi i punës. Edhe përbrenda atëherë kur dhoma e pazave gjendet në të njëjtën ndërtesë ku është edhe vendi i punës. Pauzat përbrenda ndërtesës së firmës vlejnjë vetëm atëherë si kohë me pagesë, nëse kjo në Kontratën Kolektive të Punës është paraparë si e tillë.

(Work, 22 janar 2021)

Shkarkimi: A mund të vijoj të jem edhe me tej në trustin pensional?

Firma ime është duke vuajtur shumë nga kriza e koronës. Disa kolege e kolegë vetëm se kanë humbur vendin e tyre të punës. Unë kam drojtjen se në ditët e ardhshme do të marrë shkarkimin edhe unë. Me 60 vitet e mija dhe disfavoret shëndetësore nuk do ta kem të thjeshtë të gjej një vend tjetër pune. Nëse nuk do të mund të marr një vend tjetër pune, a do të kem mundësi që së paku të vazhdojë të jem pjesë e sigurimit të pensionit profesional?

David Aebly: Po, bazuar në nenin e krijuar 47a të ligjit federal mbi sigurimin profesional pensional, i cili vlen nga 1 janari 2021. Nëse punë marrësi shkarkohet nga puna pas mbushjes së moshës 58 vjet, mund të qëndrojë edhe më tej tek enti i deritashëm pensional profesional dhe të ruajë e përfitojë nivelin e deritashëm të sigurimi pensional profesional. Më herët vazhdimi i të qenit i siguruar në arkën e njëjtë të pensionit profesional, vetëm nëse kjo është paraparë me rregulloren e entit gjegjë. Në shumicën e rasteve kondicionet nuk ishin me përparësi. Në rastet e shumta kjo nuk ishte fare e mundur. Kështu personat që humbin vendin e punës përjashtoheshin automatikisht nga enti i sigurimit pensional.


(Work, 22 janar 2021)

Aksidenti: A guxon të më shkarkojë shefi im?

Unë ka disa vite që punoi si murator i rregullt tek një firmë ndërtimi. Mjerisht para disa muajsh kam pësuar një aksident. Momentalisht marrë kompensimin e mëditjet nga sigurimi aksidental. Tani shefi im më ka shkarkuar. A është ky shkarkim i ligjshëm?

David Aebly: Jo. Ekziston koha në të cilat firma nuk guxon të shkarkojë punonjësit pas kalimit të kohës provuese. Kështu është e përcaktuar në të drejtën obligative. Nëse një person pa fajin e tij pas një sëmundjeje apo aksidenti, pjesërisht apo tërësisht i paaftë për punë, në vitin e parë të shërbimit nuk guxon që të shkarkohet gjatë 30 ditëve, në vitin e dytë gjatë 90 ditëve dhe nga viti i gjashtë i shërbimit gjatë 180 ditëve. Shkarkimi gjatë të ashtuquajturit afat embargo nuk është i vlefshëm. Për muratorët në të vërtetë vlen Kontrata Kombëtare e Punës në Ndërtimtari (LMV) Kjo disponon me rregulla mbrojtje të gjerë të shkarkimit nga puna. Një shkarkim nga punë sipas saj përjashtohet për aq kohë përsa sigurimi aksidental kompensohet paratë e mëditjeve.

(Work, 19 shkurt 2021, e adaptuar)



THYERJA E KËMBËS! Pas një aksidenti duhet të shëroheni, pa drojtjen e shkarkimit (Foto: iStock)

Lufta sindikaliste në Shqipëri

Minatori si kandidat i pavarur lufton për ulëse në parlamentin shqiptar

Parë nga aspekti ekonomik kromi është metali më i rëndësishëm në Shqipëri. Aktualisht në qytetin e Bulqizës të Qarkut të Dibrës ekzistojnë 110 ndërmarrje, të cilat janë të lejuara të nxjerrin krom. Nga eksporti i kromit arrihen rreth 100 milionë euro të hyra në vit. Në dhjetë vitet e fundit në të gjithë vendin shkak i aksidenteve në miniera kanë humbur jetën rreth 300 minatorë. Edhe përkundër numrit tragjik të viktimave asnjë nga drejtuesit e ndërmarrjeve në vitet e fundit nuk është marrë në përgjegjësi.

Osman Osmani

Sindikatat tradicionale në Shqipëri, ashtu sikur edhe në ish vendet e ashtuquajtura socialiste, nuk janë reformuar fare dhe nuk iu janë përshtatur kushteve të veprimit në sistemin neoliberal, por vazhdojnë të komandohen edhe më tej nga partitë e mëdha. Sindikatat janë shndërruar thjeshtë në zgjerime komerciale të partive brenda kompanive.

Në nëntor të vitit 2019 një grup i minatorëve nga Bulqiza kanë krijuar një sindikatë të re – Sindikatën e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës (SMBB), e cila premtonte rritjen e nivelit të përfaqësimit të interesave të punëmarrësve në industrinë e minierave, sektor ky i ekonomisë shqiptare me më së shumti raste vdekjeje. Kompania AlbChrom, e cila administron minierat e Bulqizës, pas themelimit të Sindikatës (SMBB) më 17 nëntor 2019, vetëm pak ditë më pas ka shkarkuar padrejtësisht nga puna disa nga themeluesit e sindikatës, si Elton Debreshi, Beçir Duriçi, Behar Gjimi e Ali Gjeta. Ky nuk është rast i vetëm i parregullsisve.

Në këto rrethana, minatori Elton Debreshi, njëherazi kryesues i Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, ka vendosur të paraqet kandidaturën e tij si i pavarur për zgjedhjet parlamentare të 25 prillit.

Eltoni ka deklaruar se qëllimi i tij është të përfaqësoi e mbrojë interesat e mentorëve të Bulqizës dhe të të gjithë Shqipërisë. Ai i takon gjeneratës së tretë të minatorëve nga familja e tij.

Elton Debreshi me rastin e paraqitjeve të tija para mediave ka theksuar qartas: «nëse miratohet dhe mbrohet statusi i minatorit, ai do të tërheqë kandidaturën e tij.» Synimi i tij thelbësor në nuk është që ai të merr një mandat në parlament, por këtë e sheh si mjet për të arritjen e qëllimit.




Në këto 30 vite tranzicion dhe keq menaxhim, gjatë gjithë fushatave zgjedhore nga ana e politikës është premtuar statusi i minatorit, por porsa kanë kaluar zgjedhjet, partitë që kanë fituar zgjedhjet kanë harruar premtimet e tyre.

Me 21 dhjetor 2020 minatorët sindikalistë të Bulqizës i dorëzuan parlamentit shqiptar peticionin me 10 700 nënshkrime për aprovim të statusit të minatorit.

Minatorët kanë drejtuar 4 kërkesa për parlamentin dhe politikën e vendit:

- Sigurimin e jetës për minatorët
- Rritjen e pagave dhe përfitimeve të tjera për minatorët
- Rritjen e pensioneve për minatorët
- Garantimin e kujdesit shëndetësor për minatorët dhe ish minatorët



Fitorja e tij, e cila është afër mendsh, do të ishte një histori suksesi dhe atë jo vetëm për këtë sektor, por për sindikatën e re si të tillë. Kjo fitore do të shërbente gjithashtu si një shembull e model edhe për luftërat sindikaliste në vendet përreth.

Sipas të dhënave të drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD) që nga janari deri në tetor 2020 janë eksportuar gjithsej 253 026 ton krom und ferro-krom. Me këtë rast janë nga eksportuesit më i madh i vendit, AlbChrom janë eksportuar 26413 ton ferro-krom. 226 613 ton tjera kromi janë eksportuar nga 58 ndërmarrje tjera. Kromi shqiptar në vitin 2020 është eksportuar në vendet vijuese: Mbretëria Tailandëse, Emiratat e Bashkuara Arabe, Itali, Kanada, Spanjë, Arabi Saudite, Japoni, Kili, Britani e Madhe, Shtete të Bashkuara të Amerikës, Kinë, Holandë, Rumani, Maqedoni, Austri, Zvicër, Australi, Indi, Gjermani dhe Ukrainë. Gjithashtu sipas Ministrisë për Energji e Industri për në Kinë janë eksportuar 60-65% ferro-krom (FeCr).